

**Vendim nr. 140 datë 24.06.2024**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj, Kryetare  
Marjana Semini, Anëtare  
Marsida Xhaferllari, Anëtare

në datën 24.06.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (P) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

**KËRKUES:** PASHK LLESHI, përfaqësuar nga avokate Ejona Dajçaj, me prokurë.

**OBJEKTI:** Rishikimi i vendimit nr. 35, datë 28.02.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.

**BAZA LIGJORE:** Nenet 15, 41, 42, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marsida Xhaferllari, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

**I**

**Rrethanat e çështjes**

1. Kërkuesi Pashk Lleshi në datën 09.01.2024 i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim kushtetues individual, duke kundërshtuar: (i) vendimin gjyqësor për pushimin e gjykimit administrativ të padisë së tij për pavlefshmërinë e veprimeve dhe akteve administrative; (ii) aktet administrative për marrjen e tokës në pronësi dhe për kthimin e pronës subjektivit të shpronësuar, përfshirë certifikatat e pronësisë në emër të katër shtetasve; (iii) vendimet gjyqësore për pranimin e kërkesës së prokurorit për pushimin e procedimit penal për veprat penale të pushtimit të tokës, shpërdorimit të detyrës, falsifikimit të dokumenteve dhe moskallëzimit të krimit, vepra penale të kallëzuar prej kërkuesit.

2. Kolegji i Gjykatës, me vendimin nr. 35, datë 28.02.2024 (vendimi nr. 35/2024), ka vendosur moskallimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, me arsyetimin se për dy kërkimet e para kërkuesi nuk kishte shteruar mjetet juridike në dispozicion, ndërsa kërkimi i tretë ishte haptazi i pabazuar.

3. Në datën 09.05.2024 kërkuesi i është drejtuar sërish Gjykatës me kërkesë për rishikimin e vendimit të Kolegjit të saj dhe kalimin e çështjes në seancë plenare.

## II

### Pretendimet e kërkuesit

4. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se arsyetimi i Kolegjit të Gjykatës se ai nuk ka shteruar mjetet juridike efektive për kundërshtimin e akteve administrative (AMTP-të, certifikatat e pronësisë në emër të katër shtetasve) nuk është i saktë, pasi ka qenë vetë gjykata administrative, e cila është shprehur se fillimisht duhet të gjejë zgjidhje çështja penale, për shkak se dokumentacioni në aktet e marrjes së tokës në pronësi për këta shtetas është i falsifikuar.

## III

### Vlerësimi i Kolegjit

#### A. Për legjitimitimin e kërkuesit

5. Kolegji vëren se vendimi i moskallimit të çështjes në seancë plenare mund të jetë objekt rishqyrtimi kushtetues në dy raste përjashtimore: (i) për saktësimin e tij; (ii) për rihapjen e procesit gjyqësor. Në rastin e parë përjashtimor, që lidhet me mundësinë e saktësimit të vendimit gjyqësor, neni 80, pika 1, i ligjit nr. 8577/2000 përcakton të drejtën e Gjykatës për saktësimin dhe plotësimin e vendimeve të saj. Në të njëjtën linjë, neni 43 i Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës

përcakton se vendimi i Kolegjit, Mbledhjes së Gjyqtarëve ose Gjykatës pas votimit nuk mund të ndryshohet, por veçse mund të saktësohet, plotësohet ose ndreqen gabime në shkrim apo ndonjë pasaktësi e dukshme e lejuar në të. Ndërsa, në rastin e dytë përjashtimor, që lidhet me mundësinë e rihapjes së procesit gjyqësor, referuar nenit 71/c, pikat 3 dhe 4, të ligjit 8577/2000, nëse Gjykata ka vendosur më parë për një çështje, e cila është gjykuar nga një gjykatë ndërkombëtare dhe kjo e fundit ka konstatuar se janë cenuar të drejtat dhe liritë themelore të individit, si rrjedhojë e vendimit të Gjykatës, subjekti i cenuar, në favor të të cilit ka vendosur gjykata ndërkombëtare, ka të drejtë t'i drejtohet me kërkesë Gjykatës për rihapjen e procesit gjyqësor.

6. Në çështjen konkrete, kërkesa ka në objektin e saj rishikimin e vendimit nr. 35/2024 të dhënë nga një kolegji i mëparshëm i Gjykatës, me pretendimin se ai përmban pasaktësi në arsyetimin e tij. Për të mbështetur këtë pretendim, kërkuesi ka paraqitur vendimin gjyqësor nr. 650, datë 03.12.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, me të cilin është vendosur pranimi i padisë së tij, duke detyruar organet shtetërore të kryejnë regjistrimin e pronës së tij.

7. Kolegji vëren se në vendimin e mëparshëm të Kolegjit, i cili kërkohet të rishikohet, është vlerësuar, ndër të tjera, se kërkuesi nuk ka shteruar mjetet juridike në dispozicion për kërkimin që lidhet me shfuqizimin e disa akteve administrative. Në nxjerrjen e këtij përfundimi Kolegji ka evidentuar se kërkuesi i ka kundërshtuar këto akte administrative me natyrë individuale (akti i marrjes së tokës në pronësi, vendimi i kthimit dhe kompensimit të pronave dhe katër certifikata pronësie) drejtpërdrejt në Gjykatë, për të cilat gjykatat e juridiksionit të zakonshëm nuk kishin dhënë vendim përfundimtar. Vendimi gjyqësor i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, i paraqitur nga kërkuesi, nuk rezulton të ketë pasur në objektin e tij dhe as në arsyetim vlerësim për pavlefshmërinë ose paligjshmërinë e akteve administrative të kundërshtuara nga kërkuesi, por ka vlerësuar titullin e pronësisë së kërkuetit. Në këto rrethana, Kolegji çmon se pretendimi i kërkuetit për pasaktësi në përmbajtjen e vendimit të kundërshtuar prej tij është haptazi i pabazuar.

8. Për sa më lart, Kolegji çmon se kërkuesi nuk gjendet në ndonjë prej rasteve të parashikuara në nenin 80, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenin 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës, për rrjedhojë kërkesa e tij nuk pranohet.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të nenit 80, pika 1, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar dhe nenit 43 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës,

**V E N D O S I:**

Mospranimin e kërkesës së kërkuetit Pashk Lleshi për rishikimin e vendimit nr. 35, datë 28.02.2024 të Kolegjit të Gjykatës Kushtetuese.